



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:077732

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05730805

Ac.nr.6566/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Ylber Shurdhiqi dhe Adnan Konushevci, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit N.P. nga fshati D., Komuna e Gjakovës, kundër të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me seli në Prishtinë, Rr. “Agim Ramadani”, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me përfaqësues M.K., avokat shtetëror, me objekt kontesti kompensim i të ardhurave personale, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.455/20, të datës 14.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 16.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet si e themeltë ankesa e paditësit N.P. nga fshati D., Komuna e Gjakovës, anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.455/20, i datës 14.05.2021, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Me aktvendimin C.nr.455/20, të datës 14.05.2021, Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, shpallet jokompetente lëndore për zgjidhjen e këtij kontesti dhe të gjitha veprimet e ndërmarra shpallën të pavlefshme si dhe hedhet poshtë padia. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të shkeljeve esenciale së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e

Apelit të aprovoj në tërësi ankesën dhe të ndryshoj aktvendimin duke e kthyer çështjen në procedim të mëtejshëm në gjykatën e shkallës së parë si gjykatë kompetente.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, të LPK, gjeti se:

-Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datën 30.06.2020, ka paraqitur padi ndaj të paditurës për kompensimin e të ardhurave personale, në vlerë prej 9,460.00 euro. E paditura me përgjigje në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit për shkak se e njëjta është e pasafatshme ndërsa në seancën e shqyrtimit përgatitor ka kërkuar që gjykata të shpallet jokompetente lëndore.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit përgatitor ka nxjerr aktvendimin e atakuar C.nr.455/20 të datës 14.05.2021, me të cilin është shpallur si gjykatë jokompetente, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Aktvendimin e ka mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 18, paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 19 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1, lidhur me nenin 19 të LPK-së, si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183, paragrafi 1 të LPK-së, që përbejnë arsye për anulimin e këtij aktvendimi.

Gjykata e shkallës së parë gabimisht është shpallur jo kompetente lëndore duke shfuqizuar të gjitha veprimet e ndërmarra dhe duke hedhur poshtë padinë, pasi që në rastin konkret nga kërkesëpadija e paditësit konstatohet se në këtë çështje juridike nuk kërkohet anulimi i asnjë akti administrativ por kërkohet kompensimi i të ardhurave personale për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Në këtë çështje gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike sa i përket procedurës administrative të zhvilluar pasi që në bazë të shkresave të lëndës përkatësisht aktvendimit A.nr.809/20 të datës 17.05.2021, shihet se paditësi ka zhvilluar procedurë administrative lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Andaj, duke pasur parasysh se në këtë rast është kërkuar kompensimi i të ardhurave personale, gjykata e shkallës së parë duhet që të zhvilloj procedurë gjyqësore lidhur me kompensimin e të ardhurave të paditësit, duke administruar edhe provat të nxjerra në procedurë administrative. Nga të lartcekurat gjykata ankimore vlerësoj se duhet pranuar ankesa e paditësit si e themeltë dhe të anulohet aktvendimi i atakuar ndërsa çështja të kthehet në procedim të serishëm.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që ta bëjë eliminimin e shkeljeve në pajtim me vërejtjet e paraqitura duke zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore si dhe duke vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike sa ai përket zhvillimit të procedurës

administrative nga ana e paditësit, e pas kësaj të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm konform dispozitave ligjore në fuqi.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimit në kuptim të nenit 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6566/2021, me datë 16.05.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.